

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Nr. 02-37/25-06

Prishtinë, më 14 dhjetor 2006, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 69 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Konfirmimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 30 nëntorit 2006,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për memorialin e ish Presidentit Dr.Ibrahim Rugova,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndihmën shtetërore,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bletari,
8. Shqyrtimi i propozimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor të tij,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pajisje nën presion,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për patentim,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor,
12. Shqyrtimi i Projektplanit Hapësinor të Kosovës 2005 – 2015 dhe
13. Debat për Raportin e Komisionit Evropian për Progresin në Kosovë.

Kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm për rendin e ditës dhe për materialet e shpërndara për këtë seancë.

1. Miratimi i rendit të ditës

Për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Deputeti **Hajredin Kuçi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi që Projektligji për Memorialin e ish Presidentit Dr. Ibrahim Rugova të hiqet nga rendi i ditës dhe t'i kthehet propozuesit për ripunim.

Alush Gshi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi që Projektligji për Memorialin e ish Presidentit Dr. Ibrahim Rugova të shtyhet për seancën e nesërme, me arsyetim se nuk ishte e pranishme ministrja Melihate Tërmkollli, e cila do ta arsyetonte para deputetëve këtë projektligj.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----30;
Kundër----- 48.

Kryetari konstatoi: Kuvendi nuk e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së

Pastaj kryetari e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----48;
Kundër----- 4.

Kryetari konstatoi: Shqyrtimi i Projektligjit për Memorialin e ish-Presidentit Dr.Ibrahim Rugova shtyhet për nesër.

Deputeti **Xhevdet Neziraj** (IRDK) propozoi të radhitet në rend dite ndërrimi me rotacion i anëtarit të Kryesisë së Kuvendit nga komunitetet joshqiptare dhe joserbe.

Kryetari tha se ndërrimi i anëtarit të Kryesisë nga komunitetet joshqiptare dhe joserbe është në procedurë e sipër.

Deputeti **Nait Hasani** kërkoi që IPVQ-të të kujdesen për trajtimin e tre qytetarëve tanë, që gjenden në Hagë, sikur edhe vendet e tjera të rajonit. Kuvendi të ndajë mjete financiare për ata, kurse Ministria e Drejtësisë t'u bënë vizitë zyrtare.

Ministri **Haki Shatri** propozoi që në rend dite të radhitet edhe propozimvendimi për transferin e mjeteve të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e ministrit Shatri. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Kryetari konstatoi: propozimvendimi për transferin e mjeteve financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale radhitet si pikë e fundit e kësaj seance.

Kuvendi me shumicë votash miratoi rendin e ditës me ndryshimet e bëra.

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 30 nëntorit 2006

Procesverbali i seancës plenare të 30 nëntorit 2006 u miratua pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Xhevat Bislimi** ia kishte parashtruar dy pyetje kryeministrit të Kosovës, z Agim Çeku, por ai nuk ishte i pranishëm në seancë për t'iu përgjigjur deputetit Bislimi.

Deputeti **Ferid Agani** i kishte parashtruar pyetje kryeministrit të Kosovës, z Agim Çeku, lidhur me përgjegjësinë e ministrit të Shëndetësisë për moszbatimin e Ligjit për shëndetësi. Kryeministri Çeku nuk ishte i pranishëm për t'iu përgjigjur deputetit Agani.

Deputetja **Teuta Sahatçija** pyeti ministrin e Transportit dhe të Posttelekomunikacionit për asfaltimin e rrugëve të rajonit të Dushkajës së Gjakovës.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetes Sahatçija.

Deputeti **Ibush Jonuzi** pyeti ministrin e Energjetikës dhe të Minierave lidhur me aktivizimin e minierave.

Ministri **Et'hem Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Jonuzi.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** u kishte parashtruar pyetje ministrit për Kthim dhe Komunitete, ministrit të Arsimit dhe Kryeministrit, por asnjëri nuk ishin të pranishëm. Përgjigjet mbesin për seancën e radhës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndihmën shtetërore

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Haki Shatri**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim ministri **Shatri** shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore të zbatimit të këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Shatri**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Naser Osmani, Gani Koci, Xhevdet Neziraj, Nazim Jashari, Husnija Beshković dhe Safete Hadërgjonaj**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 45;

Kundër----- 24.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash e miratoi në parim Projektligjin për tatimin në vlerë të shtuar.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Ardian Gjini**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim ministri **Gjini** shpjegoi materien, objektivat, strukturën, si dhe mënyrën e zbatimit të këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Gjini**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Jusuf Sutaj, Afrim Arzallxhiu, Mazllom Kumnova, Gazmend Muhaxheri, Xhezair Murati, Naxhije Doçi, Ramdan Kelmendi, Behxhet Brajshori dhe Zef Morina**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit, ministri **Gjini** iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 57;

Kundër----- 0;

Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash e miratoi në parim Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bletari

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri **Tomë Hajdaraj**, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, zëvendësministri **Hajdaraj** shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore të zbatimit të këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri **Hajdaraj**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Lulzim Zeneli, Berat Luzha, Xhevdet Neziraj, Teutë Sahatçija, Ramadan Kelmendi dhe Lumnije Hyseni**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 61;

Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash e miratoi në parim Projektligjin për bletari.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin me rekomandime.

7. Shqyrtimi i propozimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor të tij

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ta paraqesë rekomandimin për Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor të tij.

Sadudin Berisha, nënkryetar i Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, paraqiti rekomandimin për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor të tij. Nënkomisioni, pas intervistimit të kandidatëve, i kishte rekomanduar tre (3) kandidatë për Avokat të Popullit:

1. Ilmi Jashari,
2. Ibrahim Makolli dhe
3. Diana Toska.

Dhe tre (3) kandidatët për zëvendës kryesor të Avokatit të Popullit:

1. Palë Bali,
2. Habib Hajredini dhe
3. Lubinko Todoroviq.

Ai në vazhdim i njoftoi deputetët për procedurat e votimit.

Kryesuesi i njoftoi deputetët për formimin e Komisionit Zgjedhor prej tre zyrtarëve të stafit të administratës: Dëfim Krasniqi, kryesues, Natasha Prica, anëtare dhe Xheladin Hoxha, anëtar.

Kryesuesi kërkoi nga grupet parlamentare që ta caktojnë nga një përfaqësues për monitorimin e numërimit të votave.

Grupet parlamentare i caktuan përfaqësuesit e vet si vijon: Grupi Parlamentar i LDK-së Zahrije Maloku, GP i PDK-së - Gani Koci, GP i AAK-së – Bislum Hoti, GP i ORA-s – Teutë Sahatçija, GP 6 plus – Husnija Beshkoviq.

Kryesuesi i ftoi deputetët e Kuvendit, një nga një, të votonin për Avokatin e Popullit dhe për zëvendësin kryesor të tij.

Pas përfundimit të votimit Komisioni, nën mbikëqyrjen e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, i numëroi votat. Komisioni pas numërimit të votave, rezultatin votimit ia dërgoi kryesuesit të seancës.

Kryesuesi i kumtoi rezultatet e votimit. Kandidatët për Avokat të Popullit kanë fituar këto vota:

1. Ilmi Jashari----- 6;
2. Ibrahim makolli---41;
3. Diana Toska-----30.

Kandidatët për zëvendës kryesor të avokatit të popullit kanë fituar këto vota:

1. Palë Buli-----27;
2. Habib Hajredin-----17;
3. Lubinko Todoroviq---26.

Dy fletëvotime kishin qenë të pavlefshme.

Sipas këtyre rezultateve, në bazë të procedurave për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor të tij, votimi duhej të përsëritej për dy kandidatët që kishin fituar më së shumti vota në rrethin e parë..

Kryesuesi i ftoi deputetët e Kuvendit, një nga një, të votonin për Avokatin e Popullit dhe për zëvendësin kryesor të tij.

Pas përfundimit të rrethit të dytë të votimit, Komisioni, nën mbikëqyrjen e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, i numëroi votat. Komisioni pas numërimit të votave rezultatin e votimit ia dërgoi kryesuesit të seancës.

Kryesuesi i kumtoi rezultatet e votimit. Kandidatët për Avokat të Popullit kanë fituar këto vota:

1. Ibrahim makolli---41;
3. Diana Toska-----34.

Kandidatët për zëvendës kryesor të avokatit të popullit kanë fituar këto vota:

1. Palë Buli-----37;
2. Lubinko Todoroviq---32.

Tri fletëvotime kishin qenë të pavlefshme.

Kryesuesi i seancës kërkoi nga Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ta interpretojë Rregulloren e UNMIK-u mbi institucionin e Avokatit të Popullit dhe

të procedurave për emërimin e Avokatit të Popullit, të miratuara nga Kuvendi i Kosovës lidhur me rezultatin e votimit.

Hydajet Hyseni, kryetari i Komisionit tha se bazë të procedurave të Kuvendit për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor të tij, si dhe të konsultimeve me OSBE-në dhe me UNMIK-un për bartjen e përgjegjësive nga ndërkombëtarët tek institucionet vendore mund të konstatojmë se rezultati i votimit është i vlefshëm.

Sadudin Berisha, nënkryetar i Komisionit tha se në bazë të Rregullores së UNMIK-ut mbi institucionin e Avokatit të Popullit për ta konsideruar të vlefshëm rezultatin e votimit, kandidati për Avokatin e Popullit dhe për zëvendës kryesor të tij, duhet t'i kishte fituar 61 vota. Në bazë të rezultatit të votimit të sotëm nuk mund të konsiderohet se ata janë zgjedhur.

Kuvendi, me propozim të Alush Gashit, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Të kërkohet mendimi-komenti nga Kryesia e Kuvendit dhe nga Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me zbatimin e nenit 6 të Rregullores nr. 2006/6 mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë dhe të rregullës 11 të Rregullave të Procedurës së Kuvendit të Kosovës për emërimin e Avokatit të Popullit, të zëvendësit kryesor dhe të zëvendësve të tjerë.
2. Mendimi-komenti i kërkuar në paragrafin një (1) të këtij përfundimi t'i procedohet seancës plenare të Kuvendit të Kosovës.

Kryesuesi seancën e sotme e deklaroi të mbyllur në orën 16:40 minuta.

E hënë, 18 dhjetor 2006
Vazhdim i seancës

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Të pranishëm ishin 68 deputetë.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pajisje nën presion

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----67;
Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi Ligjin për pajisje nën presion.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për patentim

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Kryetari i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, **Ibush Jonuzi**, tha se komisioni gjatë shqyrtimit të këtij projektligji nuk e ka parë të arsyeshme të paraqes ndonjë amendament. Komisioni i rekomandon Kuvendit ta miratojë këtë projektligj në formën e propozuar nga Qeveria e Kosovës.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----69;
Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi Ligjin për patentim.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Deputeti **Hajrte din Kuçi** kërkoi nga sponsori i këtij projektligji që amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL a ndryshojnë përmbajtjen e projektligjit?

Ministri **Qemajl Ahmeti** deklaroi se amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk e ndryshojnë përmbajtjen e këtij projektligji. Qeveria pajtohet me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

Ibush Jonuzi, në emër të Komisionit Raportues tha se Komisionit i është dashur një kohë e gjatë për ta shqyrtuar këtë projektligj, nën për nën dhe në fund arriti të gjitha vërejtje e deputetëve dhe të ekspertëve të kësaj fushe, t'i përfshijë në 241 amendamente dhe të një nënamendamenti që ka në vete 116 nënamendamente, që janë të karakterit gjuhësor, teknikës juridike, por që nuk e ndryshojnë përmbajtjen e materies.

Ai propozoi që Kuvendi ta votojë këtë projektligj në paketë, në katër grupe.

Bajrush Xhemajli, nënkryetar i Komisionit FunkSIONAL tha se në këtë projektligj kanë qenë dy koncepte: a) njëri i Ministrisë së Transportit, dhe b) i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Komisioni gjatë shqyrtimit të projektligjit ka arritur t'i harmonizojë ato dy koncepte dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim.

Në diskutimet e deputetëve pati qëndrime që Kuvendi t'i votojë, një nga një, amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, kurse disa të tjerë e mbështetën propozimin e kryetarit të Komisionit.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Komisionit FunkSIONAL për t'i votuar amendamentet e propozuara në paketë, në katër grupe. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër----- 0.

Deputetët e Grupit parlamentar të PDK-së në shenjë pakënaqësie e lëshuan seancën.

Kryetari dha pauzë për konsultime.

Pas pauzës nuk pati kuorum të mjaftueshëm (44 deputetë) për t'i vazhduar punimet.

Kryetari seancën e sotme e deklaroi të mbyllur në orën 12:00.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi

Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale